



Datë: 17.03.2026
Numër Protokolli: 1404/2026

A.nr.5/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.5/2026, të datës 06.01.2026, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit: Komunës së Shtimes, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafin 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.5/2026, të datës 06.01.2026, të parashtruar nga ankuesi G.H.

A r s y e t i m

Kandidati për praninë në shërbimin civil, G.H (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesi*), më datë 06.01.2026, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimit më numër reference: RN00018981, pozita *Inspektor i Tokës Bujqësore*, i shpallur nga Komuna e Shtimes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.01.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtimes, ndërsa, kjo e fundit, më datë 13.01.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës së ankuesit, *sepse*:

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton:

- Komuna e Shtimes, më datë 11.11.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00018981, për Grupin e Shkencave Natyrore, pozita “*Inspektor i Tokës Bujqësore*”, klasa profesional 1, afati i aplikimit nga data 12.11.2025 deri më datë 11.12.2025.
- Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, por që i njëjti sipas Vendimit me Nr. 02/1-158 të datës 16.12.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk plotëson kriterin e përgjithshëm formal të konkursit sepse drejtimi Ekonomia e Bujqësisë nuk është përcaktuar si kriter i konkursit.
- Menaxheri i Personelit i Komunës së Shtimes pas përfundimit të procedurës më datë 24.12.2025 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me kandidatin fitues Labinot Jetishi me gjithsej 85.2 pikë.

II. Pretendimet ankimore:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se konkursi me Nr. Ref: RN00018981, për Grupin e Shkencave Natyrore, pozita “*Inspektor i Tokës Bujqësore*”, është shpallur në kundërshtim me katalogun e vendeve të punës dhe rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sepse kjo pozitë i takon grupit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Tokës, ndërsa me rastin e shpalljes kjo pozitë gabimisht është shpallur në grupin e shkencave natyrore, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Kërkon që të shfuqizohet konkursi, të shfuqizohet vendimin për refuzimin e aplikacionit, të shfuqizohet njoftimin për rezultatet përfundimtare dhe të obligohet institucioni që konkursi të rishpallet në përputhje me klasifikimin e saktë të pozitës.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit bazuar në të dhënat që posedon Këshilli ka gjetur se kandidatja D.SH si aplikuese në procedurën e pranimit më nr.ref: RN00018981, pozita *Inspektor i Tokës Bujqësore*, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, Këshilli më Vendimin me numër A.nr.41/2026, të datës 13.03.2026, ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit më Nr. Ref: RN00018981, për shkak se konstatimit së kriteret e konkursit kanë qenë në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës dhe Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.5/2026 ka të bëjë me procedurën e njëjtë të pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.41/2026, të datës 13.03.2026, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi këtë procedurë, si një nga qëllimet e ankuesit, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur*

apo i kot”, Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1626/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës më numër A.nr.5/2026, të datës 06.01.2026.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.5/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit G.H;
- Udhëheqësit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.